



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.259, datë 11.10.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zonja Elidjana Kasa, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, të caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Zonja Elidjana Kasa do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë nga data 25.10.2022 - 24.01.2023.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Elidjana Kasa, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Gjatë periudhës së caktimit të përkohshëm zonja Elidjana Kasa do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, në masën 40%.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 11.10.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani